



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**V E N D I M**

**Nr. 02 , Datë 03 / 01 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.155, datë 30.11.2017, të z.I. S, kundër Drejtorit të Shkollës së Mesme “Skënderbeu”, Krumë dhe Drejtorit të Zyrës Arsimore Has<sup>1</sup>; me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të gjendjes arsimore*” dhe “*të gjendjes shoqërore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**KONSTATOI:**

Referuar ankesës së sjellë pranë Zyrës së KMD-së, subjekti ankues, z.I. S shprehet se ka përfunduar shkollën e lartë, Fakultetin e Shkencave Natyrore në degën “Matematikë” me datë 20.11.1993. Ka filluar punë pranë Shkollës së Mesme “Skënderbeu”, Krumë me datën 17.11.1997 me shkëputje dhe me datë 15.09.2006 është emëruar si mësues Matematikë-Fizike pranë kësaj shkolle.

Me Urdhërin nr.15, datë 12.09.2014 të Drejtorit të Shkollës së Mesme “Skënderbeu”, Krumë “Për largim nga puna” është ndërprerë kjo marrëdhënie juridike pune.

Ankuesi informon se çështjen e largimit të tij nga puna e ka hetuar administrativisht Grupi i inspektimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e cila i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës fillimin e ndjekjes penale të Drejtorit të Shkollës së Mesme Krumë për falsifikim dokumentacioni dhe shpërdorim detyre.

Mbi këtë kallzim Prokuroria Kukës ka filluar procedimin penal me nr.403, datë 29.10.2015 dhe në përfundim të hetimit, ky organ i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, deklarinin fajtor të Drejtorit të shkollës dhe dënimin e tij për veprën penale të falsifikimit të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ZA Has.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

dokumentacionit dhe shpërdorimit të detyrës. Kërkesa e prokurorisë është pranuar nga gjykata, e cila me Vendimin nr.182, datë 02.11.2016 e ka e deklaruar fajtor atë.

Sa i takon largimit nga puna, z.S e konsideron atë në kundërshtim të hapur të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë një marrëdhënie pune, sepse akti të cilit i është referuar Drejtori i shkollës është falsifikuar prej tij. Si provë e përdorur nga Drejtori për të justifikuar largimin nga puna kanë shërbyer vërejtjet e marra në datat: 05.02.2014, 19.02.2014, 15.04.2014 dhe 22.04.2014. Sipas ankuesit këto prova nuk plotësojnë kushtet e vlefshmërisë juridike pasi pasqyrojnë rrethana të rreme, duke pretenduar se ai ka ushtruar dhunë fizike mbi nxënësit, është paraqitur në gjendje të dehur në ambjentet e shkollës, ka patur rezultate të dobëta në mësimdhënie etj. (Lidhur me këtë pretendim është shprehur me vendim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës).

Pretendimet që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, subjekti ankues i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me këtë, me vendimin nr.421 (504), datë 09.06.2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur:

- *“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhërit nr.15, datë 12.09.2014 të Drejtorit të Shkollës së Mesme “Skënderbeu” Krumë “Për largim nga puna”.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Shkollës së Mesme “Skënderbeu” Krumë dhe Zyrës Arsimore Has që të dëmshpërblejë paditësin I. S, me dy paga mujore si rezultat i mosrespektimit të afateve të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur, që të dëmshpërblejë paditësin I. S, në masën e tre pagave mujore si rezultat i mosrespektimit të afateve të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur, që të dëmshpërblejë paditësin I. S, në masën e tetë pagave mujore për largim të menjëhershëm dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Zyrës Arsimore Has, të dëmshpërblejë paditësin I. S, me tetë paga mujore, për vjetërsi shërbimi.*
- *Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet i ndarë në dy këste të barabarta, pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë”.*

Subjekti ankues, në vijim të ankesës së tij deklaroi se: *“Drejtori i Shkollës së Mesme “Skënderbeu” Krumë dhe Drejtori i ZA Has, me veprime aktive dhe haptazi në kundërshtim me ligjin po cënojnë parimin për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë për deklarimin fajtor të ish-Drejtorit të Shkollës, i cili në shpërdorim të detyrës ka urdhëruar largimin tim nga puna.*

*...Kjo e drejtë më është mohuar dhe po më mohohet sistematikisht nga ana e këtyre dy subjekteve, pasi ata e kanë detyrim ligjor që të bëjnë revokimin e urdhërit për largimin tim nga puna dhe kthimin në vendin e mëprashëm të punës”.*

Në përfundim, z.S shprehet se kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj tij nga ana e Drejtorit të Shkollës së Mesme “Skënderbeu”, Krumë dhe Drejtori i ZA Has. Po ashtu, ankuesi kërkon nga Komisioneri t’u rekomandojë këtyre dy subjekteve rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, pagesën deri në rikthimin në punë, dëmin e shkaktuar nga mosvazhdimi i kësaj marrëdhënieje pune.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti ankues në formularin e ankesës, si dhe në dokumentacionin e depozituar pranë Zyrës së KMD-së nga vetë ai, Komisioneri, konstaton se:

- **Z.I. S i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin Shkolla e Mesme “Skënderbeu”, Krumë, me Urdhërin nr.15, datë 12.09.2014 të Drejtorit të shkollës. Ankuesi ka marrë dijëni përmes njoftimit të këtij urdhëri, me datë 06.10.2014.** (Referuar Vendimit nr.421 (504), datë 09.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër<sup>3</sup>, kopje e të cilit është depozituar në dosje nga vetë ankuesi).

***Pra, subjekti ankues ka marrë dijëni për këtë fakt, (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që më datë 06.10.2014, ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 30.11.2017<sup>4</sup>, pra më vonë se një vit nga marrja dijëni; konkretisht më shumë se 3 (tre) vite.***

Po ashtu, edhe lidhur me faktin e deklaratimit fajtor të Drejtorit të shkollës për veprën penale “Falsifikim të dokumentave” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, ka marrë dijëni që me datë 02.11.2016, datë në të cilën është shpallur vendimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e z.I. S, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit ankues se vazhdon të diskriminohet nga Drejtori i Shkollës së Mesme “Skënderbeu”, Krumë dhe Drejtori i ZA Has përmes cënimit të parimit të

<sup>3</sup> Faqe nr.3 e këtij vendimi.

<sup>4</sup> Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

procesit të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë<sup>5</sup>, Komisioneri informon z.S se ndjekja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nuk është në kompetencat e Tij.

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, ka parashikuar qartësisht hapat, procedurën dhe organet përkatëse kompetente.

Kështu, në nenin 510 të tij, ka parashikuar se: *“Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm...”*

Neni 511, përcakton se: *“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili: a) për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b”, të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit...”*

Në nenin 515 të K Pr C është saktësuar organi kompetent për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, duke përcaktuar se: *“Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit”.*

Lidhur me pretendimet e ankuesit për dëmin e shkaktuar si pasojë e kohëzgjatjes së paarsyeshme në procedurat e ekzekutimit të vendimeve, K Pr C në nenin 399/1 të tij<sup>6</sup> ka përcaktuar se: *“1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë kre, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6 / 1 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.*

*2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve”.*

Lidhur me këtë pretendim, Komisioneri i rekomandon subjektit ankues ta ndjekë atë gjyqësisht.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

<sup>5</sup> Ankuesi në Dosjen e tij pranë KMD-së nuk ka depozituar asnjë vendim të formës së prerë.

<sup>6</sup> Kreu X “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”.

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

Fusha: Punësim

Shkaku: Gjendja arsimore, gjendja shoqerore